



## AKTI I THEMELIMIT

### TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"BUSHI 2002" SH. P. K.

#### NENI 1 - EMERTIMI SHOQERISE

Prej shtetasit shqiptar:

**AVION BUSHI**, i biri i Qendros dhe i Lirise, lindur ne Bolene (Vlore) me 01.05.1970 dhe po aty banues po aty ne Bolene (Vlore), eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "**BUSHI 2002**" sh.p.k.

#### NENI 2 - QENDRA E SHOQERISE

Shoqeria "**BUSHI 2002**" sh.p.k. do te kete qendren ne Bolene (Vlore) dhe do te kete te drejte te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria mund te krijoje agjensi, zyra perfaqesimi, qendra dytesore ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

#### NENI 3 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte caktuar ne masen 100.000 (njeqindmiej) lek dhe eshte teresi kapital financiar i depozituar prej ortakut themelues. Kapitali eshte i ndare ne 100 kuota me vlerë 1.000 (njemije) leke secila.

Me vendim te ortakut te vetem kapitali i shoqerise mund te rritet.

#### NENI 4 - KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin per nje periudhe prej 10 vjetesh.

Ajo do te jete subjekt i te drejtes shqiptare qe nga data e regjistrimit te saj dhe do te ushtroje veprimtarine e saj deri me 31 / 12 / 2012.

Me vendim te ortakut te vetem ky afat mund te zgjatet ose shoqeria mund te shkruhet para ketij afati.

## NENI 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do jete vijuesi:

**aktivitet:**

- ne fushen e pyllEZimeve;
- ne fushen e permiresimeve pyjore;
- ne fushen e sistemimeve malore;
- ne fushen e shfrytezimit te pyjeve;
- ne fushen e ndertimit dhe meremetimit te veprave per sigurimin e ujut te bijshem ne kullota e livadhe;

**aktivitet:**

- ne fushen e tregtimit me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore, materialeve te ndertimit, artikujve hidrosanitare, elektrike, elektroshtepiake, pjeseve te kembimit te automjeteve, pajisjeve te zyrave; import – eksporti i tyre;
- ne fushen e transportit, per vehte dhe per llogari te treteve; transporte nationale dhe internationale;
- hapja e bar-restoranteve, picericive, aktivitet ne fushen e hotelerise;
- shoqeria po ashtu mund te bashkepunoje me shoqeri te tjera me objekt te njeje ose te ndryshem nga i saj.

## NENI 6 - ORGANET DREJTUESE

Administrator i shoqerise do te jete ortaku i vetem z. AVION BUSHI.  
Drejtues Teknik i shoqerise do te jete z. BLENDAR PRIFTI.

Shoqeria "**BUSHI 2002**" sh.p.k. do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi dhe me normat e aktit themelues dhe te statutit bashkangjitur.

Ky akt themelimi nenshkruehet prej ortakut themelues ne date 01.02.2002.

### ORTAKU I VETEM

Arion Bushi

